



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 qershor 2014
Nr. ref.: RK646/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI193/13 dhe KI213/13

Parashtrues

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga personi juridik “Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K.” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e përfaqëson avokati z. Gafurr Elshani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston dy aktvendime të Gjykatës Supreme të Kosovës si në vijim:
 - Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, i 10 qershorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 15 korrik 2013, dhe
 - Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, i 12 korrikut 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 23 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, me të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI193/13 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI213/13 në Gjykatë.
7. Më 27 janar 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mori vendim për bashkimin e rasteve KI193/13 dhe KI213/13 dhe caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 5 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese ia dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës kopjen e kërkesës dhe e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktvendimit në rastet e bashkuara, KI193/13 dhe KI213/13.
9. Më 5 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve për kërkesën KI193/13

10. Më 29 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Gjykatën e tanishme Themelore) për lirimin e paluajtshmërisë dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsyetimin se i padituri Azem Sallahu, pa leje dhe autorizim kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paligjshëm, dhe nuk e ka liruar paluajtshmërinë P-71914056-00161-3, parcelën e tokës bujqësore, në vendin e ashtuquajtur “Dragodan–Kodra“, në sipërfaqe prej 10800 m², Komuna Kadastrale Prishtinë.
11. Më 13 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 2945/10, shpallet *“jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe Udhëzohet paditësja që përkitazi me këtë ta iniciojë procedurën në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës”*.
12. Më 1 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2945/10, të 13 tetorit 2011, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 24 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 1432/2011, *“REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit te paditësit Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2945/2010 i dt. 13.10.2011 VËRTETOHET”*.
14. Më 16 mars 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Supreme për dhënien e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën.
15. Më 27 mars 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme në përgjigjen agj. nr. K136/2012, në kërkesën për marrjen e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën, thekson si në vijim:

“Çështja e kompetencës është rregulluar me ligj dhe kjo Gjykatë nuk mund të marr qëndrim juridik për çdo mospajtim të palëve me vendimet gjyqësore, ju keni pas mundësi në rrugë ligjore që ta atakoni një vendim të tillë dmth. të kërkonti iniciimin e procedurës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të paraqitni revizion nëse ligji në rastin konkret ka mundësuar një gjë të tillë e pastaj kjo Gjykatë si autoritet i fundit do të vendoste lidhur me këtë çështje. Te çështja e kompetencës , gjykata nëse konsideron se nuk ka kompetencë territoriale apo reale shpallet jo kompetente dhe lëndën ia dorëzon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente, e nëse gjykata të cilës i është proceduar çështja, mendon se nuk është kompetencë e saj hap konflikt kompetence, te cilën e zgjidh gjykata me e lart, nga kjo rezulton se nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore për qëndrime juridike, por kompetenca, zgjidhet nga gjykata më e lartë, në procedurë të rregullt të parashikuar me ligj”.

16. Më 5 prill 2012, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2945/10, të 13 tetorit 2011 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1432/2011, të 24 janarit 2012, parashtruesi i kërkesës ushtron

revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 10 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 229/2012, "*HIDHET si i palejuar revizioni i përfaqësuesit të paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 1432/11 të datës 24.01.2012*", me arsyetimin si në vijim:

"Sa i përket revizionit të përfaqësuesit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoi se revizioni është i palejuar, ngase sipas nenit 228 par. 1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me te cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë, me aktvendimin me të cilën kjo gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni ,sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë ".

Përmbledhja e fakteve për kërkesën KI213/13

18. Më 22 shtator 2010, në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Gjykata e tanishme Themelore), parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi për lirimin e paluajtshmërisë dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsyetimin se i padituri Fehmi Sahiti, pa leje dhe autorizim kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paligjshëm, dhe nuk e ka liruar paluajtshmërinë P-72614055-01832, parcelën e tokës bujqësore, në vendin e ashtuquajtur "Dragodan", në sipërfaqe prej 60 ari, Komuna Kadastrale Obiliq.
19. Më 18 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 2029/10, shpallet "*jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe Udhëzohet paditësja që përkitazi me çështjen e cila është objekt i kërkesëpadisë mund ta iniciojë procedurën në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me rregullat e kësaj Dhome*".
20. Më 18 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2029/10, të 18 tetorit 2011, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 923/2012, "*REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2029/2010 i dt. 18.10.2011 VËRTETOHET*".
22. Më 16 mars 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Supreme për dhënien e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën.
23. Më 27 mars 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme, në përgjigjen agj. nr. K136/2012 ndaj kërkesës për marrjen e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën, thekson si në vijim:

“Çështja e kompetencës është rregulluar me ligj dhe kjo Gjykatë nuk mund të marr qëndrim juridik për çdo mospajtim të palëve me vendimet gjyqësore, ju keni pas mundësi në rrugë ligjore që ta atakoni një vendim të tillë dmth. të kërkonit iniciimin e procedurës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të paraqitni revizion nëse ligji në rastin konkret ka mundësuar një gjë të tillë e pastaj kjo Gjykatë si autoritet i fundit do të vendoste lidhur me këtë çështje. Te çështja e kompetencës , gjykata nëse konsideron se nuk ka kompetencë territoriale apo reale shpallet jo kompetente dhe lëndën ia dorëzon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente, e nëse gjykata të cilës i është proceduar çështja, mendon se nuk është kompetencë e saj hap konflikt kompetence, të cilën e zgjidh gjykata më e lart, nga kjo rezulton se nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore për qëndrime juridike, por kompetenca, zgjidhet nga gjykata më e lartë, në procedurë të rregullt të parashikuar me ligj”.

24. Më 12 nëntor 2012, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë, C. nr. 2029/10, të 18 tetorit 2011, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 923/2011, të 28 shtatorit 2012, parashtruesi i kërkesës ushtron revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 12 korrik 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 70/2013, *“HIDHET si i palejuar revizioni i përfaqësuesit të paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 923/12 të datës 28 shtator 2012”*, me arsyetimin si në vijim:

“Sa i përket revizionit të përfaqësuesit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoi se revizioni është i palejuar, ngase sipas nenit 228 par. 1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë, me aktvendimin me të cilën kjo gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni ,sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë “.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
27. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“Me vendimet e sipërcituara parashtruesja konsideron se i janë shkelë të drejtat në gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, ngase palët në procedurë nuk janë trajtuar në mënyrë të barabart, dhe se gjykatat nuk kanë shqyrtuar provat dhe faktet që ka ofruar i ka ofruar Paditësi - Ndërmarrja Toka e Bujqësore Shkabaj sh.p.k dhe aq ma tepër me Aktvendimin e revizionit Rev. 229/2012 të dt. 10. 06.2013. I është shkel e drejta për mjete të jashtëzakonshëm juridik sepse dhe Gjykata në faqen 2 të arsyetimit të aktgjykimit të Revizionit gabimisht interpreton nenin 228,*

par. 1, sepse aktvendimi Ac. nr. 1432/2011, është formës së prerë dhe sa i përket çështjes së kontestit mbi kompetencën përfundon procedura. Në rastin konkret procedurat ne Gjykata nuk kane qenë te drejta dhe në të shumtën e rasteve janë ndikuar nga njëra tjetra pa hy dhe analizuar faktet ne mënyrë të pavarur”.

28. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën si në vijim:

“... që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të konstaton se me Aktvendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 229/2012, të dt. 10.06.2013, dhe aktgjykimeve te ma parshme qe i kanë paraprirë të njëjtit ka shkelje te kushtetutës dhe të ligjit në aplikim, për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, ne dëm të ankuesit, me shpalljen jokompetente të Gjykatës Komunale në Prishtinë, edhepse me ligj një gjë e tillë i është garantuar. Te njëjtat Aktvendime të shfuqizohen dhe rasti të ri gjykohet ne mënyre te pa anshme dhe ne pajtim me provat”.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 21.4 dhe nenit 113.7 të Kushtetutës, të cilët parashohin:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme“.

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Si dhe nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...“.*

33. Duke marrë parasysh këtë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se me aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit

2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, "... me aktvendimin me te cilën kjo gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni, sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë ". Njëkohësisht, lëndët i janë kthyer Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për rigjykim, në mënyrë që gjykata kompetente të mund të vendosë për objektin e kontestit.

34. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis* GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).
35. Kjo gjykatë e ka zbatuar arsyetimin e njëjtë kur e mori vendimin më 27 janar 2010, për papranueshmëri në bazë të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në rastin *Universiteti AAB-RIINVEST SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, rasti nr. KI41/09 dhe vendimin e 23 marsit 2010, në rastin e *Mimoza Kusarit-Lilës kundër Komisionit Qendror Zgjedhor*, rasti nr. KI73/09.
36. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 20 dhe nenin 47 të Ligjit si dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 maj 2014, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani